



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 15695/12 Prot

Shkodër, më 16/10.2025

KONTRATË SHËRBIMI

REF-57121-08-05-2025

Mbikqyrje per objektin "Ndërtimi i strehëzës së re për qentë"


E lidhur sot me datë 16/10 /2025, midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkoder, e përfaqësuar nga **Z. Benet Beci** në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Shkoder i përfaqësuar ne kete kontrate me Vendim Delegimi nr. 277, datë 19.08.2025 nga **Z. Alban Preka** në cilësinë e zv. Kryetarit të Bashkisë Shkodër që në vijim do të quhet **Autoriteti Kontraktor**.

Dhe Operatorit ekonomik "**HTS COMPANY**" sh.p.k e paisur me licencën perkatese me nr. **MK. 3779/8** date **31.07.2025** me afat vlefshmërie deri me 17.06.2026 lëshuar nga Ministria e Infrastruktures dhe Energjise, nr **NUIS M11619018P**, regjistruar me regjistrim fillestar nr. CN-685218-04-21 me adrese: Gjirokaster, Tepelene, ZK 3574, Nr. Pasurie 14, e perfaqesuar nga Përfaqesuesi Ligjor i shoqërise **z. Skender Çela** me zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe kompetencë të plotë për tu përfaqësuar shoqërinë, në të gjitha marrëdhëniet që burojnë prej kësaj kontrate me autoritetin Kontraktor, Bashkia Shkoder për realizimin e objektit të kontratës. Në vijim do të quhet "**Kontraktuesi**" (Mbikqyresi i Punimeve).

Neni 1

Baza ligjore

- Kodi Civil ligji nr.7850, dt. 29.07.1994, i ndryshuar,
- Ligji Nr. 162, dt. 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar
- VKM nr. 285, dt. 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", e ndryshuar
- Ligji Nr.8402 datë 10.09.1998 kreu III nenet 7,15 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar.
- Vendim nr. 354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime ne planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim", i ndryshuar.
- Vendimin Nr. 610, datë 22.9.2022 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve"
- Ligji nr.48/2014 "Per pagesat e vonuara ne detyrimet kontraktore e fregtare" i ndryshuar.



Neni 2

Objekti i kontratës

- 2.1 Objekt i kësaj kontrate është shërbimi me objekt: **Mbikqyrje për objektin "Ndërtimi i strehëzës së re për qentë"** në përputhje me të gjitha termat e references të dhëna në dokumentat e tenderit dhe që **Kontraktuesi – "HTS COMPANY" sh.p.k** pranon t'i realizojë sipas ofertës së ofruar dhe pranuar si fituese në procedurën e prokurimit.

Neni 3

Vlefëta e kontratës

- a. Bazuar në VKM me Nr. 354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim" pika 8, kontraktuesi merr përsipër të kryejë të gjitha shërbimet tek Autoriteti Kontraktor sipas objektit të lartpërmendur në përputhje me të gjitha termat e references të dhëna në dokumentat e tenderit, kundrejt një vlere totale prej **234,056 (dyqind e tridhjetë e katër mijë e pesëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH ose 280,867.2 (dyqind e tetëdhjetë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë pikë dy) lekë me TVSH.**
- 3.1. Financimi realizohet nga buxheti i Bashkisë Shkodër viti 2025 miratuar me VKB nr. 76, dt. 19.12.2024, i ndryshuar.
- 3.2. Çmimet e kontraktorit për shërbimet e kryera sipas kontratës nuk duhet të ndryshojnë nga çmimet e ofruar nga kontraktori në ofertën e tij.

Neni 4

Afati i kontratës

- 4.1 Afati i kontratës do të jetë nga data e nënshkrimit të saj nga palët deri në përfundimin e punimeve. Afati për realizimin e punimeve është **6 (gjashtë) muaj**. Afati i kësaj kontrate shtrihet paralelisht me afatin e kontratës së sipërmarrjes ndërmjet Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktorit për zbatimin e objektit duke përfshirë dhe shtyrjet e mundshme të afatit që mund të lindin gjatë zbatimit të kontratës.
- 4.2 Në përfundim të periudhës së garancisë së objektit dhe bazuar në Vendimin Nr. 610, datë 22.9.2022 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve" me njoftim të Autoritetit Kontraktor, **Mbikqyrësi i Punimeve bën kontrollin përfundimtar të veprës.**
- 4.3 Mosrespektimi i detyrimeve të parashikuara në pikën 4.2 të kësaj kontrate, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundravajtje administrative dhe dënohet me gjobë në masën **50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë deri 2.000.000 (dymilion) lekë**, në përputhje me nenin 15 të ligjit "Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimeve" i ndryshuar.

Neni 5

Gjuha e kontratës

- 5.1 Gjuha e kontratës është gjuha shqipe.



Neni 6

Qëllimi

- 6.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e shërbimeve të prokurara me anë të procedurës kërkesë për propozim.
- 6.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 6.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 6.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjatë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 6.5 Kushtet e kontratës përfshijnë, gjithashtu, Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 7

Përkufizime

7.1 Kontrata

- “Kontrata” do të thotë kontrata me shpërblim, e lidhur me shkrim, ndërmjet një apo më shumë operatorëve ekonomikë dhe një ose më shumë autoriteteve kontraktore, që kanë si objekt kryerjen e punimeve, furnizimin e mallrave dhe shërbimeve, në përputhje me LPP.
- “Dokumentet e Kontratës” do të thotë dokumentet e renditura në Kontratë, përfshirë çdo ndryshim të saj.
- “Çmimi i Kontratës” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit siç specifikohet në kontratë.
- “Përfundimi” do të thotë përmbushja e të gjitha detyrimeve, me ose pa penalitete, nga Kontraktuesi në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara në Kontratë.
- “Ndërprerje e Kontratës” do të thotë mosvijimi i ekzekutimit të Kontratës sipas përcaktimeve në Nenin 23.
- “Specifikime teknike” do të thotë karakteristikat e Shërbimeve objekt kontrate dhe çdo shtesë dhe modifikim i këtyre karakteristikave në përputhje me Kontratën.
- “Termet e Referencës” shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.
- “Listat” do të thotë dokumenti (et) me titull Listat të plotësuar nga Kontraktuesi dhe të dorëzuara me ofertën, siç janë të përfshira në Kontratë. Dokumentet të tilla mund të përfshijnë Listat e Çmimeve të dhëna, Listat e tarifave dhe / ose çmimeve.

- "Ofertë" do të thotë oferta ekonomike dhe të gjitha dokumentet e tjera që Kontraktuesi ka dorëzuar me ofertën ekonomike, siç janë përfshirë në Kontratë.
- "KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.
- "KVK" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

7.2 Palët e Kontratës

- "Palë" do të thotë nënshkruesit e kontratës, në cilësinë e Blerësit dhe Kontraktuesit sipas kontekstit.
- "Blerës" do të thotë Autoriteti Kontraktor përfituesi i Shërbimeve objekt kontrate.
- "Nënkontraktor" do të thotë çdo subjekt i caktuar si nënkontraktor për kryerjen e një pjese të Shërbimeve.

7.3 Llogaritja e afateve

- "Ditë" do të thotë një ditë kalendarike.

7.4 Shërbimet

- "Shërbime" do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas Kontratës.

7.5 Përkufizime të tjera

- "Adresa e Blerësit" është adresa e specifikuar në KVK.
- "Forca Madhore" është përcaktuar në Nenin 25 "Forca Madhore".
- "Sigurimi i Kontratës" është sipas përcaktimeve të Nenit 16 "Sigurimi i Kontratës".
- "Vendi i kryerjes së Shërbimeve", do të thotë vendi i përcaktuar në KVK.
- "E paparashikueshme" ose "E paparashikuar" do të thotë një ngjarje objektivist e pamundur të parashikohet në momentin e publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE.
- Modifikimi i kontratës" është sipas përcaktimeve në Nenin 26.
- "Legjislacioni në fushën e prokurimit" do të thotë LPP-ja, Rregullat e Prokurimit Publik dhe akte të tjera nënligjore në bazë dhe për zbatim të LPP –së siç specifikohet në KVK.
- "Praktikat e Ndaluara" kanë kuptimin e përcaktuar në LPP.

7.6 Interpretimi

Interpretimi i Kontratës, përveç kur konteksti kërkon ndryshe:

- fjalët që tregojnë një gjini përfshijnë të gjitha gjinitë;
- fjalët që tregojnë njëjës përfshijnë edhe shumësin dhe fjalët që tregojnë shumësin përfshijnë edhe njëjës;
- dispozitat që përfshijnë fjalën "bie dakord", "rënë dakord" ose "marrëveshje" kërkojnë që marrëveshja të dokumentohet me shkrim;
- "i shkruar" ose "me shkrim" do të thotë i shkruar me dorë, i shkruar me makinë, printuar ose i bërë në mënyrë elektronike.



7.6.1 Modifikimi

Çdo modifikim i Kontratës i cili nuk kryhet me shkrim, dhe nuk përmban datën, apo nuk i referohet shprehimisht Kontratës dhe nuk nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar rregullisht i secilës Palë është i pavlefshëm. Palët nuk mund të bëjnë modifikime të asnjë elementi të kontratës që do të sillnin ndryshime thelbësore në kushtet mbi bazën e të cilave është përzgjedhur Kontraktuesi.

7.6.2 Heqja dorë

Çdo heqje dorë nga të drejtat, kompetencat ose mjetet ligjore të një Pale sipas Kontratës duhet të bëhet me shkrim, me datë dhe e nënshkruar nga një përfaqësues i autorizuar i Palës që bën këtë dorëheqje, dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën nga e cila po hiqet dorë.

7.6.3 Ndikimi i pavarur i dispozitave të kontratës

Nëse ndonjë dispozitë ose kusht i Kontratës është i ndaluar ose bëhet i pavlefshëm ose i pazbatueshëm, një ndalim, pavlefshmëri apo pazbatueshmëri e tillë nuk ndikon në vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e ndonjë dispozite dhe kushti tjetër të Kontratës.

7.7 Komunikimet

Kurdo këto Kushte parashikojnë dhënien ose lëshimin e miratimeve, certifikatave, pëlqimeve, përcaktimeve, njoftimeve, kërkesave dhe shlyerjeve këto komunikime do të jenë:

(a) me shkrim dhe të dorëzuara dorazi (kundrejt marrjes), dërguar me postë ose korrier, ose transmetuar duke përdorur ndonjë nga sistemet e rëna dakord të transmetimit elektronik siç përshkruhet në KVK;

Dhe

(b) dorëzuar, dërguar ose transmetuar në adresën për komunikimet e marrësit siç përshkruhet në KVK. Sidoqoftë:

(i) nëse marrësi njofton një adresë tjetër, komunikimet do të dorëzohen në përputhje me rrethanat; dhe

(ii) nëse marrësi nuk ka deklaruar ndryshe kur kërkon një miratim ose pëlqim, mund të dërgohet në adresën nga e cila është lëshuar kërkesa.

Miratimet, pëlqimet dhe përcaktimet nuk do të mbahen ose vonohen pa arsye.

7.8 Ligji dhe gjuha

Kontrata do të rregullohet dhe interpretohet sipas legjislacionit Shqiptar në fuqi.

Gjuha e Kontratës do të jetë ajo e deklaruar në KVK.

Gjuha për komunikime do të jetë ajo e deklaruar në KVK. Nëse aty nuk përcaktohet asnjë gjuhë, gjuha për komunikime do të jetë gjuha e përcaktuar e Kontratës.

Dokumentet mbështetëse dhe literatura e shtypur që janë pjesë e Kontratës mund të jenë në një gjuhë tjetër me kusht që ato të shoqërohen nga një përkthim zyrtar i fragmenteve përkatëse dhe, për qëllime të interpretimit të Kontratës, ky përkthim do të mbizotërojë.

Kontraktuesi do të përballojë të gjitha kostot e përkthimit dhe të gjitha risqet e saktësisë së një përkthimi të tillë, për dokumentet e siguruar nga Kontraktuesi.

7.9 Prioriteti i Dokumenteve

Dokumentet që formojnë Kontratën duhet të konsiderohen reciprokisht shpjeguese të njëri-tjetrit. Nëse në dokumente gjendet një paqartësi ose mospërputhje, Blerësi lëshon çdo sqarim ose udhëzim të nevojshëm.

7.10 Hartimi i Kontratës

7.10.1 Njoftimi i ofertës fituese në përfundim të afateve të ankimit do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.

7.10.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës.

7.11 E drejta e autorit

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, e drejta e autorit në të gjitha dokumentet dhe materialet e tjera që përmbajnë të dhëna dhe informacione të dhëna Blerësit nga Kontraktuesi këtu do t'i mbeten Blerësit, edhe nëse ato i janë furnizuar Blerësit drejtpërdrejt ose përmes Kontraktuesit nga ndonjë palë të tretë, përfshirë kontraktuesit e materialeve.

7.12 Detaje Konfidenciale

Kontraktuesi dhe personeli i Blerësit do të zbulojnë çdo informacion të tillë konfidencial dhe informacione të tjera që mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme për të verifikuar pajtueshmërinë e Kontraktuesit me Kontratën dhe për të lejuar zbatimin e duhur të sa

Secili prej tyre do t'i trajtojë të dhënat e kontratës në mënyrë konfidenciale, deri në masën e nevojshme për të kryer detyrimet e tyre përkatëse sipas Kontratës ose për të qenë në përputhje me ligjet në fuqi. Asnjë prej tyre nuk do të publikojë ose zbulojë të dhëna të veçanta të Shërbimeve të përgatitura nga Pala tjetër pa marrëveshjen paraprake të Palës tjetër. Sidoqoftë, Kontraktuesit lejohen të zbulojnë çdo informacion publikisht të disponueshëm, ose informacion që kërkohet për të provuar kualifikimet e tij për të konkurruar në procedura të tjera.

Pavarësisht nga sa më sipër, Kontraktuesi mund t'i sigurojë Nënkontraktorit (evë) të tij dokumente, të dhëna dhe informacione të tjera që merr nga Blerësi në masën e kërkuar që Nënkontraktori (ët) të kryejë punën e tij sipas Kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me Nënkontraktorin/ët një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit sikurse parashikohet në adresë të Kontraktuesit sipas këtij neni.

7.13 Pajtueshmëria me ligjet

Gjatë realizimit të Kontratës Kontraktuesi respekton ligjet në fuqi.

Nëse nuk përcaktohet ndryshe në Kushtet e Veçanta:

- (a) Blerësi siguron dhe paguan të gjitha lejet, miratimet dhe / ose licencat nga të gjitha autoritetet lokale, shtetërore ose kombëtare ose ndërmarrjet e shërbimeve publike në vendin e Blerësit që (i) autoritete ose ndërmarrje të tilla i kërkojnë Blerësit të sigurojë në emër të tij dhe (ii) janë të domosdoshëm për ekzekutimin e Kontratës, përfshirë ato që kërkojnë për përmbushjen e detyrimeve përkatëse si nga Kontraktuesi ashtu dhe Blerësi sipas Kontratës;
- (b) Kontraktuesi siguron dhe paguan të gjitha lejet, miratimet dhe / ose licencat nga të gjitha autoritetet lokale, shtetërore ose kombëtare ose ndërmarrjet e shërbimeve publike në vendin e Blerësit që autoritete ose ndërmarrje të tilla i kërkojnë Kontraktuesit të sigurojë në emër të tij dhe që janë të nevojshme për kryerjen e Kontratës, duke përfshirë, pa u kufizuar, vizat për personelin e Kontraktuesit dhe Nënkontraktorit dhe lejet e hyrjes për të gjitha pajisjet e importuara të Kontraktuesit. Kontraktuesi siguron të gjitha lejet, miratimet dhe / ose licencat e tjera që nuk janë përgjegjësi e Blerësit sipas pikës (a) të këtij neni këtu dhe që janë të nevojshme për ekzekutimin e Kontratës. Kontraktuesi do të dëmshpërblejë dhe zhdëmtojë Blerësin nga dhe kundër çdo dhe të gjitha detyrimeve, dëmeve, pretendimeve, gjobave, penaliteteve dhe shpenzimeve të çfarëdo natyre që lindin ose rezultojnë nga shkelja e ligjeve të tilla nga Kontraktuesi ose personeli i tij, duke përfshirë Nënkontraktorët dhe personelin e tyre, por pa cënuar Nenin 9.1.

7.14 Përgjegjësia e përbashkët dhe solidarë

Nëse Kontraktuesi është një bashkim i Operatorëve Ekonomikë, të gjithë këta Operatorë Ekonomikë do të jenë bashkërisht dhe solidarisht përgjegjës ndaj Blerësit për përmbushjen e dispozitave të Kontratës.

7.15 Inspektimet dhe Auditimi nga Blerësi

Kontraktuesi i përgjigjet pyetjeve dhe i jep Blerësit çdo informacion ose dokument të nevojshëm për (i) hetimin e pretendimeve të Praktikave të Ndalura, ose (ii) monitorimin dhe vlerësimin nga ana e Blerësit të Kontratës dhe për t'i dhënë mundësi Blerësit të shqyrtojë dhe adresojë çdo problematikë në lidhje me Kontratën.


Kontraktuesi mban të gjithë dokumentacionin në lidhje me zbatimin e Kontratës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 8

Hartimi i Kontratës

- 8.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në Dokumentat e Tenderit.
- 8.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrvëshjet midis palëve.

Neni 9



Praktikat e Ndaluar

- 9.1 Kontraktuesi nuk /do të autorizojë ose lejojë asnjë nga punonjësit ose përfaqësuesit e tij, të angazhohen në Praktika të Ndaluar në lidhje me prokurimin, dhënien ose ekzekutimin e Kontratës.
- 9.2 Nëse Blerësi konstaton se dhënia e kontratës është bërë në kushtet e konfliktit të interesit dhe ky fakt nuk ka qenë i mundur të identifikohet më parë, i kërkon Komisionit të Prokurimit Publik të deklarojë kontratën absolutisht të pavlefshme.
- 9.3 Nëse Blerësi gjatë zbatimit të kontratës ka informacion për veprime korruptive informon organet kompetente.

Neni 10

Njoftimet

- 10.1 Çdo njoftim i dhënë nga njëra Palë tek tjetra, në përputhje me Kontratën, do të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në KVK.
- 10.2 Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

Neni 11

Objekti i Furnizimit

- 11.1 Mallrat dhe Shërbimet e Lidhura me to që do të furnizohen duhet të jenë sipas specifikimeve dhe kushteve të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit.
- 11.2 Kushtet e kontratës nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese, me përjashtim të rasteve kur Kontraktuesi, për arsye objektive dhe të pavarura prej tij në kohën e ofertimit ofron, me të njëjtin çmim, kushte më të mira se ato të tenderuara.

Neni 12

Dorëzimi

- 12.1 Dorëzimi i Mallrave dhe Përfundimi i Shërbimeve të Lidhura me to do të jetë në përputhje me kërkesat e specifikuara në Dokumentet e Tenderit.

Neni 13

Përgjegjësitë e Kontraktuesit

- 13.1 Mbikqyrësi do të jetë përgjegjës për kryerjen e e të gjitha Shërbimeve në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Dokumentet e Tenderit.
- 13.2 Mbikqyrësi duhet t'i paraqesë Autoritetit Kontraktues të gjitha shërbimet, në sasi të përcaktuara, siç kërkohen nga kontrata duke përfshirë, por jo të kufizuara nga, të gjitha raportet, dokumentat, studimet, skicimet dhe planimetritë.
- 13.3 Mbikqyrësi duhet të sigurojë raportet e lidhura me zbatimin e Shërbimeve siç kërkohet në kontratë.
- 13.4 Mbikqyrësi i punimeve do të punësojë personelin e nevojshëm për kryerjen e detyrave të përcaktuara në programin e mbikqyrjes së punimeve.

13.5



- Mbikqyrësi i punimeve përgjigjet pike per pike për zbatimin e kontratës të sipërmarrjes të punimeve, të realizuar ndërmjet investitorit dhe sipërmarrësit si dhe per zbatimin e punimeve në objektin: ***"Ndërtimi i strehëzës së re për qentë"***.
- 13.6 Mbikqyrësi i punimeve përgjigjet per ndertimin e objektit ne perputhje me projektin dhe kushtet teknike te zbatimit ne fuqi per mbikqyrjen dhe pershkrimin e zbatimit te projektit, cilesine e materialeve te perdorura qe te plotesojne kerkesat e objektit si dhe per vendosjen ne veper te elementeve te parapergatitura.
- 13.7 Mbikqyrësi i Punimeve i njofton me shkrim për çdo problem që mund të lind gjatë zbatimit të punimeve, Autoritetin Kontraktor, **Drejtorinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Trajtimin të AMTP pranë Bashkisë Shkodër**.
- 13.8 Mbikqyrësi i punimeve vihet në dijeni nga investitori për nënkontraktuesit që zgjedh sipërmarrësi, ne perputhje me kontratën e nënshkruar.
- 13.9 Mbikqyrësi i Punimeve ka te drejte te kerkoje largimin nga puna te drejtuesit te kantierit ose specialisteve te vecante per mosbindje, paaftesi ose pakujdesi te rende.
- 13.10 Mbikqyrësi i punimeve pervec shërbimeve te kontrollit për zbatimin e punimeve,ndjek edhe zbatimin e grafikut të punimeve.
- 13.11 Mbikqyrësi i punimeve mban edhe dokumentacionin e mëposhtëm :
- Vendimin e Kryetarit të Bashkisë për lejen e ndërtimit.
 - Projekt zbatimin e firmosur nga projektuesi nga Bashkia, ose nga institucioni i cili ka realizu projektin.
 - Dokumentacionin topografik dhe gjeologo-inxhinierik të themeleve,të bazamenteve dhe të punimeve të maskuara.
 - Dokumentacionin përkatës per të gjitha ndryshimet e mundëshme që mund te jene bërë në projekt-preventiv gjatë zbatimit të objektit,pa prekur kushtet e vëna në vendimin e Kryetarit te lejes se ndertimit, të gjitha këto të miratuara detyrimisht nga projektuesi si dhe nga investitori duke u shoqëruar edhe me relacionin tekniko-ekonomik.
 - Planin e organizimit të punimeve.
- 13.12 Mbikqyrësi i punimeve duhet të kontrollojë periodikisht dhe ne fazat kryesore librin e kantierit,saktësinë dhe vertetësinë e dokumentave që pasqyrohen në të.
- 13.13 Mbikqyrësi i punimeve në çastin e fillimit të punimeve duhet të bëjë verifikimet paraprake si më poshtë vijnë :
Verifikimin e të gjithë dokumentacionit paraprak si liçenca,autorizime,leje,etj. të cilat sipas dispozitave në fuqi duhet të merren para fillimit te punimeve.
Verifikimin e sheshit të ndërtimit,në se është i lirë dhe i gatshëm për të filluar punimet.



Njohjen me hollësi të kontratës së sipërmarrjes dhe të gjitha akteve administrative që lidhen me të, si dhe me njohjen e të gjitha ndryshimeve të mundshme të kësaj kontrate me kalimin e kohës.

Vendosjen e tabelës së identitetit me të dhënat e mëposhtme :

- emërtimin e objektit.
- data e marrjes së lejes së ndërtimit
- investitori
- projektuesi
- sipërmarrësi dhe drejtuesi teknik i punimeve të objektit
- mbikqyrësi i punimeve
- afati i ndërtimit
- sipërfaqja e ndërtimit
- lartësia
- intensiteti sizmik i sheshit të ndërtimit, në bazë të studimit sizmiologjik dhe mikrozonimit sizmik.

13.14

Mbikqyrësi i punimeve, pas verifikimeve të përcaktuara sipas pikës së mësipërme harton dokumentacionin si më poshtë:

- aktin e dorëzimit nga sipërmarrësi të dokumentacionit teknik dhe administrativ si licënsa, autorizime e leje të marra nga sipërmarrësi
- shkresën me anë të së cilës njofton pushtetin vendor dhe degën e IMT për fillimin e punimeve.

13.15

Mbikqyrësi i punimeve, sa herë që e shihet të nevojshme gjatë zbatimit të punimeve i jep me shkrim instruksione e urdhëra sipërmarrësit dhe ky i fundit është i detyruar t'i zbatojë ato. Sipërmarrësi ruan të drejtën për t'i bërë me shkrim investitorit vërejtjet e tija në lidhje me instruksionet dhe urdhërat e marra nga mbikqyrësi i punimeve.

13.16

Mbikqyrësi i punimeve, me shpenzimet e sipërmarrësit ka të drejtë të kërkojë kryerjen e provave të materialeve të vendosura në objekt, të prodhimeve të gatëshme e gjysëm të gatëshme me të cilat furnizohet objekti apo të strukturave b/arme e të elementëve tjerë të objektit.

13.17

Mbikqyrësi i punimeve kërkon verifikimet përkatëse kur mendon se ka defekte në zbatimin e punimeve dhe kur verifikimet i japin të drejtë mbikqyrësit të punimeve shpenzimet janë në ngarkim të sipërmarrësit.

13.18

Mbikqyrësi i punimeve me miratim të investitorit ka të drejtë të pezullojë për kohësisht punimet për zbatim teknik të gabuar apo për paafësi teknike zbatimi, për atë kohë sa quhet e nevojshme korigjimi i gjëndjes.

13.19

Mbikqyrësi i punimeve kontrollon zbatimin e grafikut të hollësishëm të punimeve dhe i raporton investitorit çdo muaj për realizimin e tij.

E gjithë korespondenca e mbikqyrësit të punimeve me investitorin dhe me sipërmarrësin përbën dokumentacionin e objektit dhe si i tillë ruhet me çdo kusht.

Mbikqyrësi i punimeve mban dosjen, ku pasqyrohen të gjitha aktet e mbajtura gjatë zbatimit të punimeve të objektit që nga akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit e deri në përgatitjen e dokumentacionit për kolaudim objekti me qëllim dhenien e kuadrit të plotë të të gjitha fazave të zbatimit të punimeve.

Mbikqyrësi i punimeve pas marrjes së njoftimit me shkrim nga sipërmarrësi për përfundimin e punimeve i kërkon sipërmarrësit të punimeve dorëzimin e dokumentacionit si më poshtë :

- kontratën dhe aktet që lidhen me të.
- procesverbalet e fillimit, të ndërprerjes ose të zgjatjes dhe të përfundimit të punimeve.
- çertifikatat e provave laboratorike të materjaleve të përdorura të lëshuara nga laboratorët e autorizuar për këtë qëllim.
- deklaratën se objekti është ndërtuar në përputhje me projektin dhe me kushtet teknike.

13.20

Mbikqyrësi i punimeve firmos gjithçka që ka miratuar. Një kopje e dokumentacionit të miratuar nga mbikqyrësi i punimeve i dërgohet kolaudatorit apo grupit të kolaudimit të objektit. Në rast kur Mbikqyrësi nuk arrin të marrë dokumentacionin përkatës brenda këtij afati, për shkak që nuk mund të ngelen Kontraktorit (Sipërmarrësit e punimeve), do të aplikohen dëme të likuidueshme për kryerjen e vonuar të Shërbimeve dhe do të llogariten me tarife ditore 1/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.

13.21

Mbikqyrësi i punimeve kontrollon e miraton situacionet e paraqitura nga sipërmarrësi në fazat e ndryshme të punimeve. Paga mund të kryhet vetëm në bazë të këtij miratimi.

13.22

Mbikqyrësi i punimeve kontrollon e miraton përdorimin e fondit rezervë të preventivit dhe i raporton periodikisht investitorit për gjëndjen e tij. Ky i fundit, nëse ka vërejtje e njofton sipërmarrësin dhe problemi zgjidhet ndërmjet tyre. Për çdo ndryshim të mundshëm, mbikqyrësi i punimeve vihet në dijeni për të ndjekur zbatimin e ndryshimeve në fjalë.


13.23

Mbikqyrësi i punimeve merr pjesë në kolaudimin e objektit, i pergjigjet dhe e sqaron kolaudatorin për të gjithë dokumentacionin dhe për të gjithë paqartësitë që ka ai për kolaudimin e objektit si dhe firmos proces verbalin e kolaudimit.

13.24

Pas përfundimit të kolaudimit, mbikqyrësi i punimeve, mbështetur në kontratën e sipërmarrjes së zbatimit të punimeve dhe në aktin e kolaudimit, përcakton vlerën përfundimtare të objektit e cila i behet e ditur sipërmarrësit dhe i jepet për likuidim investitorit.

13.25



Me përfundimin e punimeve, brenda 30 diteve, mbikqyrësi i punimeve duhet të depozitojë pranë investitorit, në **Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit rural dhe trajtimit të AMTP** një relacion në dy kopje rreth zbatimit të punimeve dhe të kontratës të sipërmarrjes të zbatimit të tyre me karakteristikat dhe cilesine e materialeve të përdorura në veper duke paraqitur:

- kontratën dhe aktet që lidhen me të.
- procesverbalet e fillimit, të ndërprerjes ose të zgjatjes dhe të përfundimit të punimeve.
- certifikatat e provave laboratorike të materjaleve të përdorura të lëshuara nga laboratorët e autorizuar për këtë qëllim.
- deklaratën se objekti është ndërtuar në përputhje me projektin dhe me kushtet teknike.

13.26

Mbikqyrësi i punimeve urdhëron sipërmarrësin për të prishur e për të ribërë, me shpenzimet e këtij të fundit, punimet që nuk janë bërë me cilesinë e parashikuar dhe me materjale që nuk përmbushin standardet shqiptare apo ato europiane.

13.27

Mbikqyrësi i punimeve nuk duhet të lejojë që asnjë punim të mbulohet, maskohet apo të betonohet pa miratimin e tij. Sipërmarrësi i punimeve detyrimisht duhet të njoftojë mbikqyrësin e punimeve kur punimet e mësipërme janë gati të ekzaminohen nga mbikqyrësi i punimeve.

13.28

Mbikqyrësi i punimeve kontrollon e miraton programin e punimeve që i paraqet sipërmarrësi i punimeve, në të cilin përfshihen metodat e përgjithshme, masat paraprake pregaditore, grafiku dhe afati për të gjitha veprimtaritë e punimeve.

13.29

Mbikqyrësi i punimeve mund të shtyjë datën e përfundimit të punimeve të objektit në raste të kompensimit ose kur ndodh ndonjë ndryshim që e bën të pamundur përfundimin e punimeve dhe kolaudimin e pjesshëm apo përfundimtar të punimeve brenda datës së caktuar në kontratë për këtë qëllim, pa detyruar sipërmarrësin që të marrë masa për të shpejtuar punën e mëtejshme, gjë që do të shkaktonte shpenzime të tjera për sipërmarrësin

13.30

Nëqoftëse sipërmarrësi nuk korigjon defektin e shfaqur të ndonjë punimi dhe të njoftuar nga mbikqyrësi i punimeve brenda afatit të përcaktuar në njoftim, mbikqyrësi i punimeve do të vlerësojë koston e korigjimit të defektit dhe sipërmarrësi do të paguajë këtë shumë ose investitori do të fitojë këtë shumë nepermjet zbritjes nga shuma që i detyrohet sipërmarrësit.

13.31

Mbikqyrësi i punimeve do të kontrollojë punën e kryer nga sipërmarrësi dhe do të vertetojë shumën që duhet t'i paguhet sipërmarrësit brenda 20 ditëve punë nga data e marrjes së certifikatës së pageses (situacionit) nga sipërmarrësi. Vlera e punës së kryer



do të përfshijë vlerat e ndryshimeve dhe rastet e kompensuara në se këto do të jenë të miratuara më parë nga investitori.

13.32

Mbikqyrësi i punimeve duhet që një herë në muaj duhet të raportojë tek investitori me një relacion me shkrim në lidhje me ecurinë e punimeve në këtë objekt, duke pasqyruar gjëndjen reale të objektit në atë fazë në të cilën ndodhet në momentin e përpilimit të një raporti të tillë.

13.33

Mbikqyrësi paraqet te investitori situacionet pjesore dhe progresive për punën e kryer të shoqëruara me dokumentacionin perkatës, librezat e masave dhe projektin për zërat e kryera të punimeve, ditar punimesh, proces verbale të punimeve të maskuara, çertifikatat e cilësisë dhe analizat e laboratorit për materialet e perdoruara, realizimin e grafikut të punimeve, foto të detajuara të punëve të kryera, të gjitha konform ligjeve në fuqi.

13.34

Kur verehen shkelje te dispozitave ligjore Investitori ka te drejte t'i urdheroje Mbikqyresit te Punimeve pezullimin e punimeve dhe i lind e drejta te kryej prishjen e kontrates duke kerkuar demshperblim Mbikqyresit te punimeve per demin e shkaktuar prej tij .

13.35

Kur shkeljet e dispozitave ligjore nuk perbejne veper penale Investitori mund te denoje me gjobe Mbikqyresin e Punimeve ne masen nga 50.000 (pesedhete mije) leke deri 2.000.000 (Dymilion) leke ne perputhje te ligjit "Per kontrollin dhe disiplinimin e ndertimeve".Ne rast se Mbikqyresi i punimeve kryen shkelje financiare te cilat perbejne veper penale pergjigjet ne perputhje te legjislacionit ne fuqi.

13.36

Ne rastin e nderrimit te Mbikqyresit te Punimeve mbahet proces- verbali i dorezimit te dosjes se punimeve ku shenohen edhe shkaqet e ketij nderrimi.

Investitori ka te drejte te kerkoje largimin dhe zevendesimin e Mbikqyresit te Punimeve kur vertetohet :

Mangesi ne plotesimin e detyrave te percaktuara ne Vendimin Nr. 610, datë 22.9.2022 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve" Nderprerje e paarsyeshme e punimeve dhe zgjatje e theksuar e tyre.

Mangesi kontrolli ne kosto dhe kontabilitet, tolerim i materialeve me vlera mbi ato te preventivuara ose jo me cilesi.

13.37

Pagesa e Mbikqyresit te punimeve do ti kryhet ne baze te perqindjes se situacioneve qe do te paraqiten per likujdim nga ana e shoqerise zbatuese te objektit.

13.38

17.2 Blerësi lejohet të bëjë pagesa drejtpërsëdrejti tek nënkontraktori për furnizimet që do të kryejë, me miratimin paraprak me shkrim të Kontraktuesit

17.3 Parashikimet e Nenit 2 zbatohen edhe për nënkontraktimin.

Neni 18

Specifikime dhe Skicime

18.1 Nëse kontrata kërkon shërbime skicimi, Kontraktuesi duhet të përgatisë të gjitha specifikimet dhe skicimet duke përdorur sisteme të pranura dhe të njohura në përgjithësi të pranueshme për Blerësin dhe të marrë parasysh standartet më të fundit.

18.2 Nëse kontrata kërkon shërbime skicimi, Kontraktuesi duhet të sigurojë se të gjitha specifikimet, skicimet dhe kërkesat e tjera janë përgatitur në bazë asnjëse përsa i përket nxitjes së konkurrencës në prokurimin e objekteve të skicimit.

Neni 19

Siguracioni i Përgjegjësisë Profesionale

19.1 Kontraktuesi duhet të mbajë siguracion për përgjegjësi profesionale sipas rregullave dhe praktikave të njohura në përgjithësi për profesionin për ta zhdëmtuar Blerësin për dëme të rezultuara nga neglizhenca, gabimet ose mangësitë, në kryerjen e Shërbimeve.

19.2 Nëse nuk është përcaktuar në kontratë shuma minimale e siguracionit, Kontraktuesi duhet të sigurojë siguracion në shumën e njohur në përgjithësi si të mjaftueshme nën rrethanat e Shërbimeve që po sigurohen.

Neni 20

Dëmet e likujduara

Dëmet e likujduara për kryerjen e vonuar të shërbimeve do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore:

a) Për kontratat me periudhë zbatimi, jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 e vlerës përkatëse të mbetur, nga çmimi i përgjithshëm i Kontratës, por jo më pak se 25% e vlerës së Kontratës.


b) Për kontratat me periudhë zbatimi, jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 e vlerës përkatëse të mbetur, nga çmimi i përgjithshëm i Kontratës, por jo më pak se 25% e vlerës së kontratës.

c) Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 e vlerës përkatëse të mbetur, nga çmimi i përgjithshëm i Kontratës, por jo më pak se 25% e vlerës së kontratës.

Neni 21

Heqja dhe Zëvendësimi i Personelit Kryesor

21.1 Kontraktuesi duhet të sigurojë aprovim paraprak me shkrim nga Blerësi përpara heqjes ose zëvendësimit të personelit kryesor siç përshkruhet në ofertën e Kontraktuesit. Kontraktuesi do të zëvendësojë çdo punonjës nëse Blerësi zbulon se personi ka kryer veprime të jashtëligjshme ose Blerësi është i pakënaqur nga puna e personit.



- 21.3** Nëse bëhet e nevojshme të zëvendësohet ndonjë nga personeli kryesor, Kontraktuesi duhet të sigurojë si zëvendësues një person me kualifikime ekuivalente ose më të mira.
- 21.4** Kontraktuesi do të paguajë kosto shtesë për zëvendësimin e personelit kryesor me përjashtim kur shkaku i zëvendësimit ka ardhur nga neglizhenca ose mungesa e kujdesit të Blerësit.

Neni 22

Zhdëmtimi i Patentës

- 22.1** Kontraktuesi dëmshpërblen dhe zhdëmton Blerësin dhe zyrtarët e tij nga dhe kundër padive, veprimeve ose procedurave administrative, pretendimeve, kërkesave, humbjeve, dëmeve, kostove dhe shpenzime të çdo natyre, përfshirë tarifat e avokatit dhe shpenzimet, të cilat Blerësi mund të pësojë si rezultat i çdo shkelje ose shkelje të pretenduar të ndonjë patente, modeli, skice të regjistruar, marke tregtare, të drejte autori ose një të drejte tjetër të pronësisë intelektuale të regjistruar ose që përndryshe ekzistonte në datën e kontratës për shkak të:
- (a) ofrimit të shërbimeve nga Kontraktuesi ose përdorimit të shërbimeve në vendin e dorëzimit të Shërbimeve;
- dhe
- (b) shitjen në çdo vend të produkteve të prodhuara nga Shërbimet.
- Një zhdëmtim i tillë nuk aplikohet nëse Shërbimet ose ndonjë pjesë e tyre përdoren përtej kushteve të kontratës ose përdorimi i tyre ose i një pjese të tyre bëhet në kombinim me ndonjë pajisje, impiant ose material tjetër që nuk është furnizuar nga Kontraktuesi, në përputhje me Kontratën.
- 22.2** Nëse është nisur ndonjë procedurë apo ngritur ndonjë kërkesë kundër Blerësit që del nga çështjet e përmendura në Nenin 20.1, Blerësi do të njoftojë menjëherë Kontraktuesin, dhe Kontraktuesi mundet me shpenzimet e tij dhe në emër të Blerësit të ndërmarrë të gjitha veprimet për zgjidhjen e ndonjë procedure apo pretendimi të tillë.
- 22.3** Nëse Kontraktuesi nuk e njofton Blerësin brenda tridhjetë (30) ditëve pas marrjes së një njoftimi të tillë, atëherë Blerësi do të jetë i lirë të kryejë të njëjtën gjë në emër dhe për llogari të tij.
- Blerësi, me kërkesën e Kontraktuesit, do ti japë Kontraktuesit të gjithë ndihmën në dispozicion në kryerjen e procedurave të tilla dhe do të rimbursohet nga Kontraktuesi për të gjitha shpenzimet e arsyeshme të kryera në këtë mënyrë.
- Blerësi dëmshpërblen dhe zhdëmton Kontraktuesin dhe punonjësit, dhe nënkontraktorët e tij nga dhe kundër çdo padie, veprimi apo procedure administrative, që Kontraktuesi mund të pësojë si rezultat i çdo shkelje ose shkelje të pretenduar të ndonjë patente, modeli, skice të regjistruar, marke tregtare, të drejte autori ose një të drejte tjetër të pronësisë intelektuale të regjistruar ose që ekzistonte në datën e kontratës që lind nga ose në lidhje me çdo skicim, të dhënë, vizatim, specifikim apo dokument apo materiale të tjera të ofruara apo skicuara nga ose në emër të Blerësit.

Neni 23

Kufizimi i Përgjegjësisë

Me përjashtim të rasteve të neglizhencës së rëndë ose shkelje me dashje:

- (a) Kontraktuesi nuk do të jetë përgjegjës ndaj Blerësit, për ndonjë humbje apo dëm indirekt ose që ka si pasojë, humbje të përdorimit, humbje të prodhimit, ose humbje të fitimeve ose kostove të interesit, me kusht që ky përjashtim të mos zbatohet për asnjë detyrim të Kontraktuesit për t'i paguar Blerësit dëmet e likujduara; dhe
- (b) përgjegjësia e përgjithshme e Kontraktuesit ndaj Blerësit, nuk duhet të kalojë Çmimin e Kontratës, me përjashtim të rasteve për koston e dëmeve të rezultuara nga gabimet ose mangësitë në kryerjen e shërbimeve, ose çdo detyrim të Kontraktuesit për të zhdëmtuar Blerësin në lidhje me shkeljen e patentës.

Neni 24

Ndryshime në aktet ligjore dhe nënligjorë

Nëse pas datës së dorëzimit të ofertave ose datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj ose akt nënligjor në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa Kontraktuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

Neni 25

Forca madhore

- 25.1** Moskryerja apo kryerja me vonesë nga ana e një Pale të ndonjë prej detyrimeve të saj sipas kësaj Kontrate nuk do të konsiderohet shkelje e kësaj Kontrate nëse një mospërmbushje apo vonesë e tillë vjen drejtpërdrejt për shkak të ndonjë ngjarje të Forcës Madhore.
- 25.2** Për qëllime të këtij neni, "Ngjarja e Forcës Madhore" do të thotë një ngjarje ose situatë përtej kontrollit të një Pale që nuk është e parashikueshme, është e pashmangshme dhe nuk shkaktohet nga neglizhenca ose mungesa e kujdesit nga njëra Palë. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk kufizohen në, veprime të një Pale qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, luftërat ose revolucionet, zjarret, përmbytjet, epidemitë/pandemitë, kufizimet e karantinës dhe embargo e mallrave.
- 25.3** Nëse ndodh një Ngjarje e Forcës Madhore, Pala e prekur do të njoftojë menjëherë Palën tjetër me shkrim për gjendjen e tillë dhe shkakun e saj. Në qoftë se nuk udhëzohet ndryshe nga Pala tjetër me shkrim, Pala e prekur do të vazhdojë të kryejë detyrimet e saj sipas Kontratës për aq sa është e arsyeshme e praktikueshme dhe do të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për realizimin që nuk pengohen nga Ngjarja e Forcës Madhore

Neni 26

Modifikimi i Kontratës



- 26.1 Palët mund të modifikojnë kontratën gjatë afatit të saj, vetëm nëse ndodhen në ndonjë nga rastet e parashikuara në LPP.
- 26.2 Kur modifikimi shoqërohet me rritje të vlerës së Kontratës, vlera totale e modifikimeve nuk duhet të tejkalojë 20% të vlerës së kontratës fillestare. Kur kryhen disa modifikime të njëpasnjëshme, ky kufizim duhet të aplikohet për vlerën e përgjithshme të të gjitha modifikimeve. Kur kontrata përmban një klauzolë të rishikimit të çmimit, baza për përllogaritjen e vlerës maksimale të lejuar për modifikimet do të jetë vlera e kontratës me çmimin e përditësuar.
- 26.3 Asnjë modifikim i Kontratës nuk do të bëhet pa miratimin paraprak të Blerësit, shoqëruar me një marrëveshje me shkrim dhe të nënshkruar nga një përfaqësues i autorizuar i Kontraktuesit dhe Blerësit.

Neni 27

Zgjatja e afatit

- 27.1 Nëse në çdo kohë gjatë ekzekutimit të Kontratës, Kontraktuesi ose nënkontraktorët e tij hasin kushte që pengojnë kryerjen në kohë të Shërbimeve në përputhje me Nenin 4, Kontraktuesi njofton menjëherë Blerësin me shkrim për vonesën, kohëzgjatjen e mundshme dhe shkakun e saj. Sa më shpejt që të jetë e mundur pas marrjes së njoftimit të Kontraktuesit, Blerësi vlerëson situatën dhe në bazë të diskrecionit të tij mund të zgjasë kohën e realizimit nga ana e Kontraktuesit. Në këtë rast zgjatja miratohet nga Palët dhe reflektohet në modifikimin e Kontratës.
- 27.2 Me përjashtim të rastit të Forcës Madhore, siç parashikohet në Nenin 25, një vonesë nga Kontraktuesi në kryerjen e detyrimeve të Dorëzimit dhe Përfundimit do ta bëjë Kontraktuesin përgjegjës për pagesën e dëmeve të likujduara në përputhje me parashikimet në kontratë.

Neni 28

Ndërprerja e Kontratës

28.1 Njoftim për të korrigjuar

Nëse Kontraktuesi nuk përmbush ndonjë detyrim sipas Kontratës, Blerësi mund ti kërkojë me Njoftim që Kontraktuesi të ndreqë mospërmbushjen brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve.

28.2 Ndërprerja për mospërmbushje

Blerësi, pa cenuar ndonjë mjet tjetër ligjor në lidhje me shkeljen e Kontratës, mundet me anë të një Njoftimi me shkrim për mospërmbushje që i dërgohet Kontraktuesit, ta përfundojë Kontratën në tërësi ose pjesërisht:

- (i) nëse Kontraktuesi nuk ka përmbushur detyrimin edhe pas Njoftimit të bërë sipas pikës 28.1 të këtij neni;
- (ii) Nëse Kontraktuesi nuk ka arritur të kryejë Shërbimet brenda periudhës së specifikuar në Kontratë, ose brenda ndonjë zgjatjeje të dhënë nga Blerësi në përputhje me Nenin 27; ose

(iii) Nëse provohet se Kontraktuesi është angazhuar në Praktika të Ndaluara, siç përcaktohet në Nenin 9, gjatë konkurrimit për Kontratën apo ekzekutimit të saj.

28.3 Ndërprerja për paftësi paguese

Blerësi ndërpret në çdo kohë Kontratën duke njoftuar Kontraktuesin nëse Kontraktuesi falimenton. Kontraktuesi ndërpret në çdo kohë Kontratën nëse Blerësi nuk ka aftësi paguese. Në një rast të tillë, ndërprerja do të bëhet pa kompensim për Kontraktuesin, me kusht që kjo ndërprerje nuk do të cenojë ose ndikojë në ndonjë të drejtë padie apo mjeti ligjor që ka lindur apo do të lindë më pas për Blerësin.

28.4 Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik

a) Blerësi mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.

b) Blerësi duhet të njoftojë me shkrim Kontraktuesin për ndërprerjen.

c) Blerësi duhet të paguajë Kontraktuesin për të gjitha Shërbimet e kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë Kontraktuesit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjesshme të Shërbimeve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, Kontraktuesit do t'i kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

Neni 29

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

29.1 Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi duhet të bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore përmes bisedimeve të drejtpërdrejta çdo mosmarrëveshje që lind midis tyre gjatë ekzekutimit të Kontratës.

29.2 Nëse, palët nuk arrijnë të zgjidhin mosmarrëveshjen e tyre me një konsultim të tillë të ndërsjellë, atëherë secila Palë mund t'i njoftojë Palës tjetër për qëllimin e saj për të shkuar në Gjykatë.

Neni 30

Përfaqësimi i Palëve

30.1 Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose strukturë organizative, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me ekzekutimin e kontratës.

a) Personi që do të jetë përgjegjës, në emër të **Autoritetit Kontraktor** për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me ekzekutimin e kontratës do të jetë **Ing. Viktor Sheldija** me detyrë **inxhinier ndërtimi** pranë Drejtorisë së përgjithshme të Mirëmbajtjes së Objekteve Publike.

cel/tel/fax 069 6411 334

E-mail: ppmop@bashkiashkoder.gov.al

b) Personi që do të jetë përgjegjës në emër të Kontraktuesit për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me ekzekutimin e kontratës do të jetë z. Skender Ceta Drejtues Teknik i Shoqerise

E-Mail: htscompany21@gmail.com

Tel: 069 349 9020



Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqësuesit të palës. Nëse njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marri përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.

30.2 Palët mund të emërojnë persona ose struktura organizative shtesë për të përfaqësuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta në të cilin rast njoftimi me shkrim duhet dhënë dhe duhet të përcaktojë shtrirjen e autoritetit të përfaqësuesit.

30.3 Në zbatim të VKM nr. 285, dt. 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", kreu XIII, neni 107, pika 6, "Zbatimi dhe mbikqyerja e kontratës", në përfundim të kontratës, **Ing. Viktor Sheldija** si personi që do të jetë përgjegjës, në emër të Autoritetit Kontraktor për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me ekzekutimin e kontratës do të përgatisin një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, problemet e hasura gjatë zbatimit të kontratës dhe masat e marra për zgjidhjen e tyre, nëse është rasti paraqet një informacion për likudimin ose jo të kontratës. Një kopje e këtij raporti i jepet edhe kontraktorit, me kërkesë të tij.

30.4 Personi përgjegjës duhet të ndjekë me përpikëri ecurinë e zbatimit të kontratës, për t'u siguruar se zbatimi bëhet sipas termave dhe kushteve të kontratës. Personi përgjegjës, në funksion të legjislacionit të prokurimit publik ka/në këto përgjegjësi:

- a) harton e ndjek ecurinë e planit të zbatimit të kontratës;
- b) kryen monitorimin e zbatimit të detyrimeve të palëve në kontratë, në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë;
- c) administron dhe verifikon dokumentacionin e dorëzuar nga kontraktori, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- ç) sigurohet për kontrollin real e ligjor të kostove, cilësisë dhe afateve, kur është rasti;
- d) menaxhon dhe trajton problematikat që shfaqen gjatë ekzekutimit të kontratës dhe që nuk sjellin domosdoshmërisht ndryshime/ modifikime/ përshtatje të saj;
- dh) raporton te titullari i autoritetit/entit kontraktor për shkelje të dispozitave kontraktuale;
- e) administron kërkesat për ndryshime/ modifikime/përshtatje të zbatimit të kontratës dhe sigurohet që këto kërkesa të kalojnë për miratim në strukturat përkatëse, brenda afateve të përcaktuara në kontratë;
- ë) mban korrespondencën e përditësuar me të gjitha dokumentet e shkëmbyera me kontraktorin lidhur me zbatimin e kontratës;
- f) përgatit informacion për çështjet e sipërcituara dhe ia përcjell personit përgjegjës për prokurimin, i cili raporton pranë APP-së

Neni 31

Lajmërimet

- 31.1 Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetër sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë.
- 31.2 Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.



Neni 32

Llogaritja e Afateve

Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe.

Neni 33

Vlefshmeria e kontratës

- 33.1 Kjo kontratë u hartua ne pesë kopje origjinale, katër për Autoritetin Kontraktor dhe një për Kontraktuesin, dhe pasi u lexua, firmoset rregullisht nga palet
- 33.2 Kjo kontratë do të quhet e vlefshme duke filluar nga data e nënshkrimit të saj nga palët.

KUSHTET E VEÇANTA TË KONTRATËS

Kushtet e mëposhtme të veçanta të Kontratës do të plotësojnë KPK. Nëse ka një konflikt, dispozitat e KVK do të mbizotërojnë mbi ato në KPK.

Neni 1

Dispozitat e Përgjithshme

- 1.1 Blerësi është: **Bashkia Shkodër**
Adresa: Rr. "13 dhjetori", Nr. 1 Shkodër
Telefoni: +35522400150
Numri i faksit: _____
E-mail: info@bashkiashkoder.gov.al
- 1.2 Kontraktuesi është: **HTS COMPANY**
Adresa: Gjirakaster Tepelene ZK 3574, Nr Pasurie 14/130-N1, Vol 7 Fq. 121
Telefoni: 069 349 9020
Numri i faksit: _____
E-mail: htscompany21@gmail.com
- 1.3 Gjuha për komunikimet është: **Gjuha shqipe**
Gjuha është: **Gjuha shqipe**

Neni 2

Sigurimi i Kontratës

- 2.1 Sigurimi i Kontratës në shumën prej (10% të vlerës së ofertës) duhet të ofrohet nga Kontraktuesi për të siguruar ekzekutimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.
- 2.2 Sigurimi i Kontratës do t'i lëshohet ose kthehet, menjëherë Kontraktuesi sipas formularit të mëposhtëm: Jo më vonë se 30 ditë pas datës së marrjes në dorëzim te punimeve.

Neni 3

Vendndodhja e Shërbimeve



- 3.1 Shërbimet do të kryhen në vendet sipas përcaktimeve në termat e referencës.

Neni 4

Fillimi i Zbatimit

- 4.1 Afati për realizimin e punimeve është 6 (gjashtë) muaj.
4.2 Afati i kontratës do të jetë nga data e nënshkrimit të saj nga palët deri në përfundimin e punimeve.

Neni 5

Informacion që duhet dhënë nga Autoriteti Kontraktor

- 5.1 Brenda 15 ditësh nga marrja e sigurimit të kontratës, Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit informacionin dhe dokumentat që ai i vlerëson si të domosdoshme për përmbushjen e shërbimit nga Kontraktuesi.

Neni 6

Kërkesat e Raportimit

- 6.1 Gjatë zgjatjes së kontratës, Kontraktuesi duhet të sigurojë raporte për Autoritetin Kontraktor sipas formularit të mëposhtëm: Në përputhje me grafikun e shërbimit.

Neni 7

Siguracioni i Përgjegjësisë Profesionale

- 7.1 Përpara fillimit të zbatimit të kontratës, Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktor me prova për siguracionin e përgjegjësisë profesionale me shumë minimale si vijon: Nga Data e hyrjes deri në Afatin e Mbarimit kontraktori duhet të ketë siguracion që mbulon deri në shumën prej:
- a. Për dëmtime ose humbje të Punëve dhe Materialeve.
 - b. Për dëmtime ose humbje të Pajisjeve.
 - c. Për dëmtime ose humbje të pasurisë përveç Punëve, Materialeve dhe Pajisjeve.
 - d. Për dëmtim personal ose vdekje të personave në kantier.

Neni 8

Kushtet e Pagesës

- 8.1 Pagesa për shërbimet, do të bëhet brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit mes palëve ***të certifikatës së përkohshme të marrjes në dorëzim të punimeve.***
8.2 Monedha e pagesës do të jetë: LEKE.
8.3 Në zbatim të ligjit nr. 87/2019 "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit", i ndryshuar, fatura e lëshuar nga kontraktuesi duhet të jetë elektronike.
8.4 Të gjitha pagesat e shumave që i detyrohen Kontraktuesit mund të bëhen vetëm në llogarinë bankare të Kontraktuesit.

Neni 9

Garancia

- 9.1 Periudha e vlefshmërisë së garancisë do të jetë si më poshtë:
Siç specifikohet në nenin 2, kushtet e veçanta.



Neni 10

Të drejtat dhe detyrimet e Autoritetit Kontraktor

- 10.1 Investitori i dorëzon mbikqyrësit të punimeve të objektit, në momentin e lidhjes së kontratës për mbikqyerjen e punimeve, dokumentacionin si më poshtë :
- Projekt zbatimin e firmosur nga projektuesi, nga Bashkia ose nga institucioni i cili ka realizu projektin.
 - Preventivin e ofertës fituese (të sipërmarrësit) të firmosur nga anetarët e komisionit të vlerësimit të ofertave dhe të miratuar nga kryetari i autoritetit kontraktor.
 - Kontratën e lidhur ndërmjet tij dhe sipërmarrësit për sipërmarrjen e zbatimit të punimeve të objektit.
 - Specifikimet teknike të punimeve të objektit dhe përshkrimin e shkurtër të tyre të shoqëruar me raportin teknik të projektuesit.
 - Kopje të vendimit të Kryetarit për lejen e ndërtimit
 - Një pjesë të dokumentacionit ligjor-administrativ të sipërmarrësit si licenca, stafi teknik, paisjet e makineritë që do të perdoren, etj.
- 10.2 Investitori i dorëzon sipërmarrësit të punimeve një kopje të kontratës të lidhur ndërmjet investitorit dhe mbikqyrësit të punimeve për mbikqyerjen e punimeve të objektit.
- 10.3 Investitori duhet të njohë mbikqyrësin e punimeve me çdo ndryshim që mund t'i bëjë ai kontratës të lidhur me sipërmarrësin e zbatimit të punimeve.
- 10.4 Investitori bën likuidimin e pagesës për çdo situacion të paraqitur nga mbikqyrësi i punimeve brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga dita e paraqitjes së situacionit pjesor ose progresiv apo përfundimtar për mbikqyerjen e punimeve.
- 10.5 Investitori (zyra e investimeve) kontrollon e miraton procesverbalin e preventivin shtesë për punimet që shtohen apo pakësohen në rast se gjatë zbatimit të punimeve për shkaqe të ndryshme lind nevoja e shmangies nga projekti apo që janë parashikuar me pak në preventivin fillestar.
- 10.6 Investitori brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit nga sipërmarrësi i zbatimit të punimeve për përfundimin e punimeve të objektit, merr në dorëzim nga mbikqyrësi i punimeve dosjen e objektit dhe i njofton atij datën e kolaudimit të punimeve të kryera sipas kontratës të sipërmarrjes së zbatimit të punimeve të objektit.
- 10.7 ***Në rast kur Mbikqyres i nuk arrin të dorëzojë dokumentacionin përkatës brenda këtij afati, do të aplikohen dëme të likuidueshme për kryerjen e vonuar të Shërbimeve dhe do të llogariten me tarife ditore 1/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlere do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.***
- 10.8 Investitori mund të kërkojë largimin apo zëvendësimin e mbikqyrësit të punimeve kur verteton mangësi serioze në veprimtarinë e tij si :
- Mangësi në realizimin e detyrave të përcaktuar në pikën "1" të kësaj kontrate
 - Ndërprerje e paarsyeshme të punimeve dhe zgjatje e theksuar pa shkak të tyre

- 10.9 Në qoftë se me përfundimin e afatit të kontratës së mbikqyrjes së punimeve të përcaktuar në kontratën e mbikqyrjes së punimeve, punimet e sipërmarrjes së zbatimit të punimeve nuk përfundojnë, me kerkese të supervizorit dhe të dokumentuar me prova teknike dhe të miratuara nga investitori realizohet kontrata shtese me mbikqyrjesin e punimeve me afat kohor deri në përfundim të punimeve të sipërmarrjes së zbatimit të tyre.
- 10.10 Në qoftë se investitori nuk vepron kështu, atëherë kontrata e mbikqyrjes së punimeve quhet e perfunduar dhe nga mbikqyrësi i punimeve investitori merr në dorëzim dosjen e mbikqyrjes së punimeve të objektit.
- 10.11 Investitori duhet t'i përgjigjet me shkrim kërkesave, vrejtimeve e sygjërimeve të mbikqyrësit të punimeve brenda kohës së domosdoshme për të mos vonuar vazhdimin e punimeve ose zbatimin e tyre pa miratimin e tij (investitorit).
- 10.12 Investitori ka të drejtën e monitorimit të kësaj kontrate dhe fazës së realizimit të kryerjes së punimeve gjatë gjithë kohës në këtë objekt .

AUTORITETI KONTRAKTOR
BASHKIA SHKODËR
Përfaqësuar me vendim delegimi
Zv/Kryetar i Bashkisë
Alban PREKA



PËR OPERATORIN EKONOMIK
HTS COMPANY SH.P.K
Përfaqësues ligjor
Skënder ÇELA

